V E N D I M
Nr.465, datë 6.10.1999

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI "BASHKËRENDIMIN E VEPRIMEVE TË ORGNEVE TË KONTROLLIT SHTETËROR DHE SUBJEKTEVE QË VEPROJNË NË PORTET DETARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores mbi "Bashkërendimin e veprimeve të organeve të kontrollit shtetëror dhe subjekteve që veprojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë".

2. Për kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe institucionet e tjera shtetërore e subjektet që veprojnë në porte.

3. Çdo institucion dhe subjekt që vepron në porte, të hartojë rregulloren e vet të brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko